



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

**R A P O R T**

**PËR DEKRETIN NR.5315, DATË 15.5.2007 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR  
PROJEKTLIGJIN “PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 28 maj 2007, shqyrtoi dekretin nr.5315, datë 15.5.2007 të Presidentit të Republikës për projektligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Gjatë diskutimit Komisioni mori në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit European, të paraqitura në fazën e hartimit dhe shqyrtimit të projektligjit nga Këshilli i Ministrave, si dhe pas miratimit të tij nga Kuvendi.

Vlerësimi i deputetëve për dekretin është si më poshtë:

**Mendimi i shumicës:**

Shumica e deputetëve nuk i konsideron të drejta argumentet e dhëna në letrën e Presidentit të Republikës për mosdekretimin e ligjit, për këto arsye:

1. Funkcionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit janë të ndryshme dhe nuk mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën. Auditimi i brendshëm është veprimtari e brendshme e institucioneve dhe ka qëllim përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të tyre, ndërsa Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur nga Këshilli i Ministrave dhe kryen auditimin e jashtëm të institucioneve që përdorin fonde të Buxhetit të Shtetit. Njësitë e auditimit të brendshëm raportojnë për veprimtarinë e tyre audituese tek titullari i institucionit, ndërsa Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton në Kuvend për veprimtarinë e tij kontrolluese.
2. Objekti i auditimit të brendshëm është i ndryshëm nga ai i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Auditimi i brendshëm, nëpërmjet vlerësimeve të riskut, performancës, sistemeve të kontrollit dhe të drejtimit, vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit mbulon në rradhë të parë çështjet e rregullshmërisë, të administrimit dhe të vlerësimit.
3. Drejtorja e Përgjithshme e Auditimit nuk mundet nëpërmjet këtij ligji të marrë funksionet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kontrolli i Lartë i Shtetit është kontrolli më i lartë ekonomik dhe financiar dhe veprimtaria e tij realizohet nëpërmjet ligjit për KLSH-në, cili është ligj organik dhe si i tillë, prevalon mbi ligjin për auditimin e brendshëm, që miratohet me shumicë të thjeshtë.

4. Neni 26 i ligjit mbështetet në rekomandimet e Komisionit Europian të datës 16 tetor 2006, në të cilat sugjerohet përfshirja në projektligj e rregullave që sigurojnë një bashkëpunim të mirë midis institucionit më të lartë të auditimit dhe njësisë të auditimit të brendshëm, siç janë pjesëmarrja e Kontrollit të Lartë të Shtetit në zhvillimin e standardeve të kontrollit të brendshëm, në trajnime të përbashkëta, në përgatitjen e planeve apo raporteve të auditimit etj.

#### **Mendimi i pakicës:**

Pakica mbështeti argumentet e Presidentit të Republikës për antikushtetueshmërinë e ligjit, me këto arsye:

1. Fusha e zbatimit të ligjit për auditimin e brendshëm, e përcaktuar në nenin 2 të tij, është e njëjtë me atë të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e përcaktuar në nenin 163 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar. Të dy këto institucione kontrollojnë veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike qendrore e vendore, si dhe të personave juridikë me kapital shtetëror mbi 50 për qind.
2. Ligji i jep Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit kompetencën të auditojë institucionet e pavarura dhe organet e pushtetit vendor. Dhënia e kësaj kompetence një drejtorie që është në varësi të Ministrit të Financave çënon pavarësinë e këtyre institucioneve.

**Rezultati i votimit:** 8 vota kundër, 1 pro dhe 1 abstenim.

KRYETARI  
Edmond Spaho

Tiranë, më 2.7.2007